



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV
Sesioni pranveror
Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 55
Prishtinë, më 17 prill 2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Berat Buzhala, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Petar Miletij.

I pranishëm në mbledhje, ishte zëvendëskryeministri i parë z. Behgjet Pacolli, me ftesë të Komisionit që të raportojë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK, Besnik Ramadani-KDI, Sanije Berisha-OSBE, praktikantë dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i zëvendëskryeministrit të parë, z. Behgjet Pacolli;
3. Diskutim lidhur me Draft-Rezolutën e KPJ të Parlamentit Evropian për procesin e integritetit evropian të Kosovës;
4. Përcaktimi i ligjit për mbikëqyrje dhe formimi i grupit punues;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Raportim i zëvendëskryeministrit të parë, z. Behgjet Pacolli;

Albin Kurti – vlerësoi gatishmërinë e zëvendëskryeministrit të parë, z. Behgjet Pacollin, për të marrë pjesë në këtë takim, i ftuar me ftesë të Komisionit. Fillimisht kërkoi nga z. Behgjet Pacolli të bëjë një përshkrim të shkurtër të fushëveprimit, qëllimit dhe aktiviteteve të tij.

Behgjet Pacolli – zëvendëskryeministër i parë, informoi se është i angazhuar nga kryeministri i Kosovës të llojë për njohje të reja të Kosovës dhe se këtë punë e kryen në mënyrë korrekte dhe me angazhim të madh. Njoftoi se ka lobuar edhe nga pozita kur ishte deputet, dhe si rezultat i lobimit janë sjellë 11 nota verbale, ndërsa si zëvendëskryeministër i parë i Republikës së Kosovës, në vitin 2011 janë sjellë 13 njohje ndërsa në vitin 2012 janë sjellë 14 njohje. Duke marrë parasysh vështirësitë e lobimit, tha se është krenar me këto të arritura. Gjithashtu, theksoi se, gjatë lobimit, qëllimi i tij nuk ka qenë vetëm të sjellë nota verbale për njohje, por edhe të krijoj një imazh të cilin Kosova sot e posedon. Njoftoi se pjesë e angazhimit ka qenë edhe intensifikimi i bashkëpunimit me shtetet ku ka lobuar. Sa i përket lobimit tha se, qëllimisht zgjodhi shtetet e Afrikës sepse e konsideron atë kontinent të ardhshëm, ku tani jetojnë mbi 1 milion e 500 mijë kinezë përfaqësues të ndërmarrjeve të ndryshme të biznesit. Lidhur me investimet tha se investitorëve duhet t'iu krijohen kushte për investime, me ç'rast përkujtoi se kishte kërkuar që të bëhej një ndryshim në Ligjin për agjencionin e privatizimit, në mënyrë që asetet e Agjencionit të privatizimit të përdoren si instrument për krijimin e partneritetit privat dhe publik. E quajti si një humbje kohe promovimin e idesë së ndërtimit të një termocentrali mbi dy mijë megavat, ndërsa privatizimi i PTK-së, tha se është dashur të bëhej para gjashtë viteve, kur telefonja mobile ishte në trend dhe kishte vlerë më të madhe. Sa i përket Trepçës, tha se është kundër shitjes së saj dhe se ka një platformë jashtëzakonisht të mirë për t'ia rritur vlerën. Theksoi se tani Kosova është e njohur nga 99 vende dhe se procesin e lobimit e ka të fokusuar në Amerikën Qendrore, Afrikë dhe Azinë Jugperëndimore, ndërsa me rastin e lobimit, ka përdorur strategjinë e lobimit përmes presidentëve. Ka dy raporte pune, një për vitin 2011 dhe një për vitin 2012 të ilustruara me agjenda të udhëtimeve, të cilat janë të publikuara edhe në internet.

Albin Kurti – kërkoi nga zëvendëskryeministri të njoftojë edhe për disa çështje që ndërlidhen me detyrat e tij, me ç'rast ia parashitroi këto pyetje: Cila është platforma juaj për politikën e jashtme? A i koordinoni veprimet tuaja me akterët e tjerë në fushën e politikës së jashtme në Kosovë, me MPJ dhe presidenten? Kujt i raportoni Ju në lidhje me aktivitet tuaja dhe sa herë keni raportuar deri më tani? Cila është forma e bashkërendimit tuaj me MPJ lidhur me njohjet? A është formalizuar, përcaktuar roli që zëvendëskryeministri Pacolli do të ketë në kuadër të procesit të njohjeve, sidomos mënyra e komunikimit në mes të kabinetit të tij, kabinetit të ministrit të jashtëm dhe përfaqësive diplomatike të Kosovës? Sa të shpeshta janë kontaktet e juaja me ministrin e jashtëm, sidomos në lidhje me bashkërendimin e veprimtarisë së përbashkët? Si bëhet ndarja e punëve në mes të zëvendëskryeministrit të parë në njërin anë dhe presidentes, kryeministrit dhe ministrit të jashtëm në anën tjetër? A mendoni, z. Pacolli, që ministri i jashtëm, siç e kërkon logjika kushtetuese dhe qeveritare, duhet t'iu bindet për njohjet, a ndodhë kjo në praktikë, nëse jo, a po vepron ministri i jashtëm në kundërshtim me këtë detyrim kushtetues dhe qeverisës? Politikisht, a mendoni që jeni përjashtuar nga shërbimi i jashtëm? A e dini që legjislacioni për shërbimin e jashtëm nuk parashikon ndonjë rol për funksionin që ju e ushtroni politikisht? Pse nuk keni propozuar që roli dhe rëndësia e pozita juaj të përcaktohet me dispozita ligjore dhe në këtë mënyrë t'i zgjidhni kundërthëniet në politikën e jashtme? Pse strategjia për njohjet nuk parashikon ndonjë rol, buxhet të veçantë për zëvendëskryeministrin e parë në kuadër të këtij procesi? Sa është roli juaj në përputhje apo komplementar në kuadër të strategjisë së njohjeve? Cili është roli i ministrisë dhe ambasadave në koordinim dhe vendosjen e takimeve lobuese tuaja? Në cilat raste ambasadorët e Kosovës kanë qenë pjesë e delegacioneve tuaja? Në çfarë forme kabineti juaj transmeton mesazhet e njohjeve, notat verbale apo mesazhet tjera të rëndësishme në MPJ, sidomos në rastet kur shtetet respektive kërkojnë nga Kosova që të ndërmarrë apo të përmbahet nga ndonjë veprim i caktuar? Kryetari i Komisionit në vazhdim pyeti edhe se: A na ka njohur Mali, a na ka

njohur Uganda e Nigeria? Mbështetur në shkrimet në gazetën “Shekulli” të muajit shtatorit të vitit të kaluar, a mendoni se është e drejtë që në emër të Kosovës të kërkoj njohje një zyrtar i lartë i shtetit që është nën hetime, sa e rëndon kjo imazhin e Kosovës? Mbështetur në deklaratën në RTK se Rusia nuk ka bërë asnjë hap për ta penguar njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shtetet tjera, a jeni në dijeni se WikiLeaks ka nxjerrë një kablo që dëshmon se Rusia, më saktësisht Medvedev, ka lobuar kundër njohjes së Kosovës? A jeni në dijeni se ambasadori rus në Beograd ka folur haptas kundër pavarësisë së Kosovës? A ka aplikuar Kosova për ulëse në OKB? Sa shtetësi i keni, z. Pacolli? Pse nuk na ka njohur Kazakistani deri më sot, dhe a jeni shtetas i Kazakistanit?

Hydajet Hyseni – këtë komunikim institucional të zëvendëskryeministrit dhe të Komisionit e vlerësoi si obligim të ndërveprimit midis Kuvendit dhe Qeverisë dhe shumë të dobishëm. Pyeti zëvendëskryeministrin se cili do të ishte koncepti më i preferuar për strukturimin e ardhshëm në fushën e politikës së jashtme, është kjo që kemi mënyra më e mirë e organizimit me dy tre zëvendëskryeministra, me fusha jo sa duhet të ndara, me kufij jo krejt të qartë midis MPJ, zëvendëskryeministrave, kryeministrit, presidentes dhe institucioneve të tjera. Po ashtu e pyeti zëvendëskryeministrin se cili është vendi i diplomacisë parlamentare në angazhimin e jashtëm të Kosovës edhe nga përvoja juaj edhe nga përvoja jonë.

Donika Kadaj-Bujupi – kërkoj të njoftohet nga zëvendëskryeministri pse nuk ishte pjesë përbërëse e delegacionit në Rusi, në mënyrë që të ndihmoj për të na njohur Rusia, si dhe kërkoj të shpjegohet më konkretisht se çfarë forme e lobimit është në vendet afrikane, ku ka shumë firma kineze.

Behgjet Pacolli – theksoi se nuk ka lobuar tek firmat kineze, në vendet afrikane.

Sabri Hamiti – theksoi se nuk ka ndonjë pyetje për zëvendëskryeministrin, por e ftoi në mbledhjen plenare të Kuvendit me rastin e debatit për Trepçën, që atje t’i shpalosë idetë e tij për Trepçën.

Skender Hyseni – vuri në pah mospërputhjen e deklaratës së ministrit të jashtëm se janë 96 njohje me atë të zëvendëskryeministrit se Kosova është njohur nga 99 vende, dhe këtë e vlerësoi mosgatishmëri për të dhënë një numër të saktë të dakorduar, nga dy anëtarë të kabinetit qeveritar. Lidhur me anëtarësimin e Kosovës në OKB theksoi se Kosova nuk mund të bëhet anëtare e OKB-së, pa rekomandim të Këshillit të Sigurimit i cili i procedohet Asamblesë të Përgjithshme, në këtë rast vetëm nëse Federata Ruse dhe Republika Popullore e Kinës nuk e ushtrojnë të drejtën e vetos.

Berat Buzhala – në diskutimin e tij në mes tjerash, theksoi se është dëshmitarë i dy takimeve lobuese të zëvendëskryeministrit në Londër, për njohje nga shtetet Vanuatu dhe Swaziland. Këto dy vende tha se e njohën Kosovën pas disa javësh nga takimi, falë kontributit të z. Pacollit, pa e korruptuar shtetin tonë. Pyeti zëvendëskryeministrin se, sa ka shpenzuar nga buxheti i tij personal për procesin e lobimit për njohje të pavarësisë së Kosovës.

Emilija Rexhepi – vlerësoi punën e zëvendëskryeministrit për të cilin tha se ka kontribuar shumë për shtetin tonë dhe në emër të komunitetit pakicë e falënderoi edhe për punësimin e pakicave, konkretisht të komuniteti boshnjak.

Behgjet Pacolli – duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga kryetari i Komisionit tha se është angazhuar nga Qeveria për të lobuar për t’i sjellë njohje të reja Kosovës dhe për të promovuar mundësitë e Kosovës jashtë vendit, tek investitorët e huaj. Lidhur me platformën e politikës së

jashtme tha se ajo i takon MPJ, ndërsa si zëvendëskryeministër, ka për detyrë të gjejë rrugën me të mirë, më të volitshme, më humane, më profesionale që të trajtohet Kosova në të ardhmen. Ai njoftoi se ekziston koordinim i punëve me MPJ dhe se është i hapur për kontaktim me çdokënd. Njoftoi se për punën e tij i raporton kryeministrit Hashim Thaçi dhe se pas çdo rruge përgatitë një raport të shkurtër për ta njoftuar kryeministrin. Me MPJ tha se ekziston bashkëpunimi, atje është duke u bërë një punë e mirë dhe pak a shumë punët janë të ndara në mes të MPJ dhe zëvendëskryeministrit. Roli i tij tha se është i formalizuar përmes vendimit të kryeministrit, ku qartë i është përshkruar veprimtaria në kuadër të Qeverisë. Kontaktet me ministrin Hoxhaj, tha se janë të shpeshta por për shkak të angazhimeve të mëdha nuk mund të jemi shumë kohë bashkë. Nga shteti i Papua New Guinea, tha se e ka notën verbale qysh para dy viteve, por kjo njohje ishte bllokuar përmes ambasadës së këtij vendi. Zëvendëskryeministri njoftoi se nuk ekzistojnë kundërthënie në politikën e jashtme, por shprehje mendimesh të ndryshme të cilat nxisin për punë dhe suksese më të mëdha. Roli i zëvendëskryeministrit tha se ka mundur të rregullohet me ndonjë ligj, por kjo nuk është bërë. Në bazë të rregullores së Qeverisë, kryeministri ka të drejtë të caktojë një zëvendëskryeministër për një çështje të caktuar. Njoftoi se roli i tij është në përputhje me strategjinë për njohje dhe se në këtë strategji nuk është ndarë ndonjë buxhet për rolin tij. Gjatë lobimit tha se shumë rrallë i ndodhë që të kërkoj ndonjë shërbim nga ambasadorët tanë, nga fakti se është numër i vogël i tyre dhe se në shumë vende ku lobon nuk ka ambasador të Kosovës. Njoftoi se në një vizitë në Nju-Jork, ka pasur ndihmën për takime nga konsulli ynë atje. Mesazhet që vijnë për njohje tha se origjinalin e tyre e përcjell në MPJ, ndërsa vendeve të cilat na njohin ju përcjellin falënderim dhe i ftojnë për thellimin e bashkëpunimit dhe për lidhje të marrëdhënieve diplomatike. Lidhur me njohjet e Kosovës nga Nigeria, Mali e Uganda, zëvendëskryeministri shpjegoi procesin e lobimit për njohje nga këto vende. Ai njoftoi se Nigeria *de facto* e ka njohur Kosovën ndërsa *de jure* ende nuk e ka njohur. Shteti i Malit tha se *de jure* e ka njohur Kosovën, por për shkak të gjendjes së luftës atje, tani nuk mund të shkoj në Mali për ta rikonfirmuar këtë njohje, ndërsa Uganda tha se na e njeh *de facto* Kosovën, kurse nota verbale për njohje ende nuk ka arritur.

I pyetur lidhur me deklaratën se Rusia nuk ka bërë asnjë hap për t'u penguar njohja e Kosovës, shprehu mendimin e tij për raportet në mes të Serbisë dhe Rusisë dhe për strategjitë e tyre gjeopolitike. Ai po ashtu tha se nuk ka parë në asnjë vend të botës asnjë letër të shtetit rus ku thuhet që të mos njihet Republika e Kosovës. Duke njoftuar për angazhimet për njohje në 48 vende, tha se njohjen nga Pakistani nuk e konsideron si kontribut të tij edhe pse me përfaqësues të këtij shteti ka pasur takime të shumta. Ai njoftoi edhe për angazhimet e tij dhe takimet për lobim me ministrin e MPJ të Bangladeshit. Njoftoi se ka thënë se Kosova duhet të aplikojë në shtator në cilësi të vëzhguesit në OKB, dhe se sikur të kishte pasur mundësinë dhe potencialin institucional do të angazhohej që në shtatorin e kaluar të kërkojë që Kosova të ketë vendin e vëzhguesit në OKB. Njoftoi se nuk është bërë aplikimi në OKB dhe nëse do të kërkohet angazhimi i tij, ai do të kontribuojë. Zëvendëskryeministri Pacolli, njoftoi se e ka shtetësinë e Kosovës dhe atë të Zvicrës. Theksoi se është qytetar nderi i Kazakistanit dhe i dy qyteteve në Shqipëri. Vlerësoi përkrahjen e Kazakistanit për heqjen e taksave ndaj 10.000 punëtorëve nga Kosova që punojnë atje, ndihmën në Bankën Botërore, njohjen e pasaportave të Kosovës dhe pranimin e përfaqësuesve institucional të Kosovës. Njohja nga Kazakistani tha se do të vijë, por është e ndërlikuar për shkak të ndërlidhjeve ekonomike që ka ky vend me Rusinë. Njoftoi se nuk ka qenë i ftuar të jetë pjesë e delegacionit për të udhëtuar në Rusi, dhe se në këtë vend nuk udhëton prej se është në Qeverinë e Kosovës.

Hydajet Hyseni - zëvendëskryeministrin Pacolli e falënderoi për raportim dhe kërkoi që ky komunikim të vazhdojë edhe në të ardhmen, dhe të krijohet mundësia e trajtimit të çështjeve në mënyrë të sistemuar.

Donika Kadaj-Bujupi - kërkoi të informohet nga zëvendëskryeministri Pacolli, se sa investitorë i ka sjellë në Kosovë, cila është vlera e atyre investimeve, sa vende pune i ka hapur dhe kërkoi që të sillet me shkrim, shuma e shpenzuar për lobim nga buxheti i Kosovës.

Behgjet Pacolli - lidhur me çështjet e parashtruara nga deputetja D.Kadaj-Bujupi, S.Hyseni, e B.Buzhala njoftoi se ka qenë i interesuar që të bëjë një ndryshim në Ligjin për Agjencionin e privatizimit, lidhur me investimet por kjo çështje tha se nuk ka hasur në mirëkuptim. Ndër investimet theksoi hapjen e fabrikës së galanterisë në Gjakovë. Udhëtimet për lobim tha se kryesisht i mbulon vetë, me ç'rast ceku se vetëm për një udhëtim të fundit, ku shkuarja ka zgjatë 6 orë, ka paguar me aeroplan privat, për një orë fluturimi 5.000 euro. Nga buxheti i Kosovës për dy vite, tha se ka shpenzuar për lobim, 71 mijë euro. Sa i përket pyetjes se a kanë ndodhë metoda korruptive në procesin e njohjeve, z. Pacolli tha se nuk din për metoda korruptive në këtë proces. Ai theksoi se ka blerë kompjuterë për Mali për shkak të rrethanave atje, ngase është në natyrën e tij njerëzore të japë, nëse diku është e nevojshme. Njoftoi se në ndërmarrjen e tij i ka 2600 të punësuar në Kosovë, dhe 9300 punëtorë jashtë Kosovës.

3. Diskutim lidhur me Draft-Rezolutën e KPJ të Parlamentit Evropian për procesin e integritetit evropian të Kosovës;

Albin Kurti – tha se Mocioni për Rezolutë i KPJ të Parlamentit Evropian për procesin e integritetit evropian të Kosovës, sipas draftit të dt. 6 mars 2013, përmban disa probleme. Me këtë dokument për herë të parë në PE, Kosova është paraqitur me fusnotë. Ai i theksoi mangësitë të cilat i përmban ky dokument në faqe 2, paragrafin e dytë, në faqe 3, pika 8, se askund nuk thuhet dialogu Kosovë-Serbi por thuhet dialogu Prishtinë-Beograd. Thuhet se është problematike transparenca sa i përket financimit të shkollave dhe spitaleve në veri, mirëpo nuk është vetëm transparenca problematike por problematike janë edhe kurrikulat dhe strukturat ilegale. Dokumenti tha se përmban edhe shumë çështje të tjera problematike dhe mangësi.

Pas diskutimeve të deputetëve: A.Kurti, S.Hamiti, H.Hyseni, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

T'i dërgohet një shkresë Parlamentit Evropian me konstatimin se në Mocionin për Rezolutë, nuk është e arsyeshme që Kosovës t'i referohen me fusnotë, ngase nga ky institucion njihet pavarësia e Kosovës. Në këtë shkresë të ceken edhe disa nga çështjet problematike në përmbajtjen e Mocionit për Rezolutë të KPJ të Parlamentit Evropian.

4. Përcaktimi i ligjit për mbikëqyrje dhe formimi i grupit punues;

Anëtarët e Komisionit diskutuan për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, nga fushëveprimi i Komisionit, se cili nga ligjet do të përcaktohet për mbikëqyrje të zbatimit nga Komisioni si dhe për formimin e grupit punues për ta zbatuar mbikëqyrjen e ligjit .

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të mbikëqyret zbatimi i Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare nr.04/ L-52.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, formohet grupi punues në përbërje nga deputetët: Hydajet Hyseni, Berat Buzhala e Donika Kadaj-Bujupi.

5. Të ndryshme.

Albin Kurti - për rritjen e nivelit të mbikëqyrjes së ekzekutivit, tha se do të ishte e nevojshme edhe matja e performancës së shërbimit tonë të jashtëm. Propozoi që të hartohet një draft-matricë indikatorësh për të vlerësuar performancën, impaktin dhe përgjegjshmërinë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës. Anëtarët e Komisionit përkrahën propozimin për hartimin e një drafti për matjen e performancës së shërbimit të jashtëm, i cili më pas do të shqyrtohet në Komision.

Takimi përfundoi në orën 14:00.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit